



REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA GLLOGOC GLLOGOC MUNICIPALITY			
PRANUAR	05/06	2023	
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
01-400/0	26624		



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit
Drenas, më 05.06.2023

Ftesë

Për pjesëmarrje në takim lidhur me dëgjimin e parë publik për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2024-2026

Njoftohen të gjithë qytetarët e Komunës së Drenasit, administratorë të vendbanimeve, përfaqësues të lagjeve, OJQ-të, shoqata e grave, shoqëria civile, biznese të Komunës së Drenasit, se më datën 12.06.2023, do të fillojnë dëgjimet buxhetore për të diskutuar Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2024-2026.

Ndërsa në muajin Korrik, do të fillojnë dëgjimet buxhetore për të diskutuar Draft-Buxhetin Komunal 2024-2026.

Korniza Afatmesme Buxhetore dhe Draft- Buxheti Komunal 2024-2026 janë të një rëndësie të veçantë për Komunën e Drenasit, prandaj ju qytetarë të nderuar, shfrytëzoheni të drejtën tuaj që të jeni pjesëmarrës aktiv në këto dëgjime publike, ku me propozimet dhe vërejtjet e juaja, ju do të kontribuoni në përmirësimin e cilësisë së jetës suaj.

Më poshtë gjeni vendin e mbajtjes së dëgjimit:

Dëgjimet publike për KAB 2023	Vendi, data dhe koha	Bartësit përgjegjës të dëgjimit	Bartësit mbështetës të dëgjimit	Vartësit përgjegjës për njoftim dhe vendin e mbajtjes së dëgjimit
Dëgjimi i parë publik me qytetarë për KAB-in Komunal 2024-2026	Komuna e Drenasit Salla e Kuvendit Më datë 12.06.2023 E Hënë, ora 11:00	Grupi Punues për dëgjimet Buxhetore 2024-2026 sipas vendimit të kryetarit 01 Nr.400/01-8586 i dt. 15.02.2023	Kryetari i Komunës, Kryesuesi i Kuvendit, Zyra e Informimit, Drejtorë të Drejtorive dhe njësitë tjera të komunës	Zyra për Informim, Drejtorët e Drejtorive, Zyra për Barazi Gjinore, përfaqësues të fshatrave, lagjeve dhe lokaliteteve që të njoftojnë qytetarët për pjesëmarrje

Ju mirëpresim!



Kryetari i Komunës
Hamiz Lladrovci